


Treguesit demografikë

Tremujori III – 2024

Tiranë, më 12 shkurt 2025: Shtesa natyrore e popullsisë për tremujorin e tretë 2024 rezulton pozitive, duke regjistruar 752 lindje më shumë se sa vdekje, ku:

- Numri i lindjeve për tremujorin e tretë 2024 është 6.495, duke shënuar një rënie me 0,3 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2023;
- Numri i vdekjeve për tremujorin e tretë 2024 është 5.743, duke shënuar një rritje prej 7,6 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2023.

Fig. 1: Shtesa natyrore e popullsisë



** Të dhëna paraprake


Pesë qarqe të vendit regjistrojnë shtesë natyrore pozitive të popullsisë, ndërsa në shtatë qarqe të tjera, shtesa natyrore e popullsisë është negative.

Qarku me shtesën natyrore më të lartë është Tirana, me 1.032 lindje më shumë sesa vdekje, ndërsa qarku me shtesën natyrore më të ulët është Fieri, me 176 vdekje më shumë se sa lindje.

Për publikim: 12/02/2025

Vijon

Fig. 2: Lindjet, vdekjet dhe shtesa natyrore sipas qarqeve, T3–2024**



** Të dhëna paraprake

Lindjet

Në tremujorin e tretë 2024, pesë qarqe të vendit shënojnë rritje të numrit të lindjeve, ndërsa shtatë qarqe të tjera shënojnë ulje të numrit të lindjeve, në krahasim me tremujorin e tretë 2023.

Qarku me numrin më të lartë të lindjeve është Tirana me 2.438 lindje, ndërsa qarku me numrin më të ulët është Gjirokastra me 90 lindje.

Në tremujorin e tretë 2024, rritjen më të madhe në përqindje të lindjeve e ka qarku i Shkodrës me 12.0 %, ndërsa rënien më të madhe e ka qarku i Gjirokastrës me 23,7 %, në krahasim me tremujorin e tretë 2023.

Tab. 1: Lindjet sipas qarqeve

Nr.	Qarku	2023-3	2023-4	2024-1**	2024-2**	2024-3**
	Shqipëria	6.515	6.226	5.056	5.269	6.495
1	Berat	249	235	164	192	211
2	Dibër	279	280	234	245	309
3	Durrës	736	700	556	587	730
4	Elbasan	555	587	431	449	573
5	Fier	562	513	421	436	569
6	Gjirokastrë	118	108	74	70	90
7	Korçë	360	332	282	310	315
8	Kukës	177	173	169	148	198
9	Lezhë	312	290	216	221	275
10	Shkodër	393	396	328	318	440
11	Tiranë	2.457	2.326	1.929	2.013	2.438
12	Vlorë	317	286	220	248	309
	<i>*Të panjohur</i>	0	0	32	32	38

*Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrin e lindjeve të gjalla, për të cilat informacioni i qarkut ku është regjistruar lindja mungon.¹

** Të dhëna paraprake

Vdekjet

Në tremujorin e tretë 2024, dy qarqe të vendit shënojnë ulje të numrit të vdekjeve, ndërsa dhjetë qarqe të tjera shënojnë rritje, në krahasim me tremujorin e tretë 2023.

Qarku me numrin më të ulët të vdekjeve është Kukësi me 141 vdekje, ndërsa qarku me numrin më të lartë është Tirana me 1.406 vdekje.

Në tremujorin e tretë 2024, rënien më të madhe në përqindje të vdekjeve e zë qarku i Dibrës me 5,7 %, ndërsa rritjen më të madhe e ka qarku i Fierit me 31,6 %, në krahasim me tremujorin e tretë 2023.

¹ Shiko metodologjinë në linkun në vijim: <http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/lindjet-vdekjet-dhe-martetat/#tab4>

Tab. 2: Vdekjet sipas qarqeve

Nr.	Qarku	2023-3	2023-4	2024-1**	2024-2**	2024-3**
	Shqipëria	5.338	5.159	5.537	5.014	5.743
1	Berat	270	272	287	237	299
2	Dibër	212	210	225	192	200
3	Durrës	521	500	547	453	538
4	Elbasan	505	490	530	504	582
5	Fier	566	569	584	607	745
6	Gjirokastrë	160	169	176	162	172
7	Korçë	492	485	499	497	474
8	Kukës	137	122	139	110	141
9	Lezhë	211	247	262	222	236
10	Shkodër	445	400	414	395	459
11	Tiranë	1.379	1.352	1.454	1.272	1.406
12	Vlorë	440	343	408	345	454
	<i>*Të panjohur</i>	0	0	12	18	37

**Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrine vdekjeve, për të cilat informacioni i qarkut ku është regjistruar vdekja mungon.*

*** Të dhëna paraprake*

Metodologjia

Të dhënat tremujore për lindjet dhe vdekjet, në nivel kombëtar dhe qarku përbëjnë një hallkë të rëndësishme të demografisë së vendit. Ato paraqesin të dhëna mbi ndryshimet në popullsi, të cilat kanë impakt në jetën ekonomike dhe sociale të vendit. Këto të dhëna publikohen mbështetur në Programin e Statistikave Zyrtare 2022-2026.

Lindjet

Të dhënat e lindjeve:

Të dhënat e lindjeve sipas karakteristikave bazë demografike sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila dërgon në INSTAT vetëm numrin e lindjeve të banuesve në Shqipëri. Konsiderohen të gjitha lindjet e banuesve në Shqipëri gjatë periudhës referencë, duke mos marrë parasysh lindjet e banuesve jashtë Shqipërisë (emigrantëve), edhe pse mund të regjistrohen në zyrat e gjendjes civile, pranë ish-vendbanimeve të tyre.

Regjistrimet e vona të lindjeve

Kryhet një rregullim i vogël i numrit të lindjeve që regjistrohen vonë për vitin aktual, në mënyrë që të përfshijmë të gjitha lindjet e ndodhura në periudhën referencë.

Numri i lindjeve të regjistruara vonë nga viti i mëparshëm janë konsideruar si një proxy për regjistrimet e vona të vitit aktual, duke konsideruar supozimin (si rezultat edhe i analizave tona të vazhdueshme) që numri i regjistrimeve të vona të lindjeve nuk ndryshon shumë nga viti në vit.

Vdekjet

Të dhënat e vdekjeve

Të dhënat e vdekjeve, sipas karakteristikave bazë demografike sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila dërgon në INSTAT vetëm numrin e vdekjeve të banuesve në Shqipëri. Konsiderohen të gjitha vdekjet e banuesve në Shqipëri gjatë periudhës referencë, duke mos marrë parasysh vdekjet e banuesve jashtë Shqipërisë (emigrantëve), edhe pse mund të regjistrohen në zyrat e gjendjes civile pranë ish-vendbanimeve të tyre.

Regjistrimet e vona të vdekjeve

Bëjmë një rregullim të vogël të numrit të vdekjeve që regjistrohen vonë për vitin aktual, në mënyrë që të përfshijmë të gjitha vdekjet e ndodhura në periudhën referencë.

Numri i vdekjeve të regjistruara vonë nga viti i mëparshëm janë konsideruar si një proxy për regjistrimet e vona të vitit aktual, duke konsideruar supozimin (si rezultat edhe i analizave tona të vazhdueshme) që numri i regjistrimeve të vona të vdekjeve nuk ndryshon shumë nga viti në vit.

Përkufizime:

Shtesa natyrore e popullsisë: Shpreh rritjen/rënien e popullsisë, si rezultat i proceseve biologjike (lindjeve dhe vdekjeve) të saj, gjatë një periudhe kohe.

Ky tregues shprehet si diferencë ndërmjet lindjeve dhe vdekjeve.

Lindje e gjallë: Lindjet e fëmijëve që shfaqën shenja jete.

Vdekje: Nënkupton zhdukjen e përhershme të të gjitha shenjave të jetës, në çdo kohë pasi ka ndodhur një lindje e gjallë (ndërprerjen e funksioneve vitale, pa aftësinë e ringjalljes).